



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI

Tiranë, më 30.12.2012

Njoftim për Shtyp

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI
ISH KRYETARIN E BASHKISË PËRMET**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 990/1 prot., datë 6.9.2012 të ushtruar në Bashkinë Përmet, ka konstatuar një sërë shkeljesh lidhur me shitjen e trojeve brenda vijës kufizuese të qytetit të Përmetit, në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, dhe Ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”.

Si pasojë e këtyre shkeljeve të konstatuara, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka çuar në Prokurorinë e Rrethit për kallëzim penal, ish kryetarin e Bashkisë Përmet për periudhën 2008 -2011, me akuzën “Për shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi në kundërshtim flagrant me ligjin ka nënshkruar aktin noterial të shitjes ndaj subjekteve private të pronës shtetërore (truall) ndonëse nga verifikimet e bëra gjatë procesit të auditimit rezultoi se pala shitëse Bashkia Përmet nuk ka qenë pronare e trojeve që ajo ka shitur me anë të kontratës noteriale.

Për të gjitha veprimet e mësipërme i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.